



VENDIM
Nr. 41 Datë 31.05.2010

PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
LICENSIMIN E SHOQËRISË “DISHNICA ENERGJI” SH.P.K

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 gërma “a”, nenit 9 dhe 13 pika 1, gërma “a”, të Ligjit nr.9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, nenit 18, pika 1, gërma “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, date 18.03.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 31.05.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “DISHNICA ENERGJI” sh.p.k, si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

- Aplikimi plotëson përgjithësisht kërkesat e ERE-s lidhur me liçensimet në sektorin e energjisë elektrike të:
- **Formatit të aplikimit (neni 9, pika 1)**
- **Dokumentacionit juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2)**
- **Dokumentacionit finciar dhe fiskal (neni 9, pika 3)**
- **Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4)**

Mungesa e Dokumentacionit që ka të bëjë me pikën 4.1.5 gërmat “a” dhe “c” të nenit 9, perkatesisht: Miratimi i OST – së dhe OSSH – së për lidhjen e centralit në rrjetin elektrik të tregëtimit dhe Leja Mjedisore nga organet përkatëse është në pritje për t’u plotësuar.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave për licensimin e shoqërisë “DISHNICA ENERGJI” sh.p.k në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga “Hec - DISHNICE”.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



-
2. Ngarkohet Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar NEPRAVISHTA

